REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Procesverbal

Konsultim publik : Plani i Arsimit Parauniversitar, Plani i Integritetit, Plani i Shërbimit Social, Plani i Barazisë Gjinore, Plani i Menaxhimit të Mbetjeve.

Data : 08.08.2025 **Ora** :10.00 **Vendi**: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : totali 22; nga të cilët 19 gra dhe vajza, 3 meshkuj (sipas listës bashkëlidhur).

Pjesëmarrës: Janë pjesëmarrës nga këshilli bashkiak Prrenjas: nga bashkia Prrenjas Drejtori i Financës **Suzana Kapxhiu,** Specialisti për Barazinë Gjinore **Mirela Dashi**, Koordinator për Njoftimin dhe konsultimin publik **Rudina Kukli**; dhe grupe të interesit.

Gjatë këtij takimi Drejtoresha e Financës Suzana Kapxhiu foli për të gjithë pjesëmarrësit për Planet 3 vjeçare të Bashkisë Prrenjas, Mirela Dashi shpegoj për Barazinë Gjinore, prioritetet dhe vëmendjen që do ti jepet këtyre planeve:

1. **Planet e Arsimit**
2. **Plani i Integritetit**
3. **Plani i Shërbimit Social**
4. **Plani i Barazisë Gjinore**
5. **Plani i Menaxhimit të Mbetjeve**

Adresa. Rruga : "Skënderbeu", Godina: 15, Tel. 05912/2404/ 22605, www.bashkiprrenjas.gov.al, e-mail:bashkiaprrenjas@hotmail.com

Diskutimet kryesore:

- U diskutua për nevojën e mbështetjes me psikologë dhe punonjës socialë në shkolla.
- Prindërit kërkuan transport të rregullt për nxënësit në zonat e largëta dhe më shumë aktivitete jashtëshkollore.

- znj. , Naeda Bogdani theksoi rëndësinë e partneriteteve me organizata që ofrojnë trajnime për mësuesit dhe nxënësit, nje bashkepunim.

Rekomandime:

- Hartimi i një harte të nevojave emergjente për çdo shkollë.
- Thellimi i bashkëpunimit me komunitetin për edukimin familjar.

Takim për Planin e Integritetit Institucional "Plani i Integritetit të Bashkisë Prrenjas 2025–2028"

Diskutimet kryesore:

- U theksua domosdoshmëria e një mekanizmi funksional për sinjalizuesit .
- Përfaqësues të shoqërisë civile kërkuan publikimin periodik të shpenzimeve dhe monitorim të prokurimeve publike.
- U diskutua per transparencen dhe raportet ne website

Rekomandime:

- Trajnime për integritet në çdo drejtori.
- Transparenca në faqen e bashkisë për publikim të informacioneve qe skane nevoje per të pagese.

Takim për Planin Vendor të Shërbimeve Sociale 2025–2027 dhe i Barazisë Gjinore"Plani Vendor i Shërbimeve Sociale në Bashkinë Prrenjas"

Diskutimet kryesore:

- Specialist ne Sherbim Social znj. Mirela Dashi paraqiti strukturën e re të shërbimeve për fëmijët, të moshuarit dhe personat në nevojë.
- Kërkesa për rritje të fondeve për ndihmën ekonomike dhe mbështetje për gratë viktima të dhunës.
- U propozua ngritja e një strehëzës për raste urgjente.

Rekomandime:

- Bashkia të hartojë një plan bashkëpunimi me Qendrat Shëndetësore dhe Policinë për ndërhyrje të koordinuar.
- Themelimi i një bordi monitorues me përfaqësues nga komuniteti.

Konsultim publik: Takim për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve 2026–2028

"Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për Bashkinë Prrenjas"

Diskutimet kryesore:

- Koordinatori i Mjedisit Gordana Karaj prezantoi masat për reduktimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve.
- U ngritën shqetësime për mungesën e kosheve në zona të thella dhe nevojën për fushata ndërgjegjësuese.
- Propozime për ndarje në burim të mbetjeve në institucionet publike.

Rekomandime:

- Ngritja e një pike grumbullimi për riciklim.
- Inkurajimi i bizneseve për të zbatuar praktika të gjelbra.

Mbajtësi i procesverbalit

Koordinatori për Njoftimet dhe konsultimet publike

Rudina Kukli







